



AKT-THEMILIMI i SHOQERISE TREGTARE "AJEK" SH.P.K.

Ne baze te nenit 2 te ligjit nr.7512, date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private te nismes se lire, te veprimtarive private te pavaruar te privatizimit" dhe zbatim me ligjin nr.7638, date 19.10.1992, "Per shoqerite tregtare" behet themelimi i shoqerise "AJEK", me seli ne qytetin e Elbasanit, lagja "Shën Koll", Fax-tel. 35-26, e mbeshtetur ne statutin e kesaj shoqerie me ortake zotin

THEMISTOKLI BEBI, shtetas shqiptar.

VENDOS :

Te krijoje nje Shoqeri Tregtare te emertuar "AJEK" SH.P.K. kushtet e meposhtme:

NENI 1

Themeluesit ne cilesine e ortakteve krijojnë shoqerine tregtare "AJEK", SH.P.K. me statusin juridik te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.7638, date 19.11.1992, (Per shoqerite tregtare), me mjetet e veta financiare dhe duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjilacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statusin e bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "AJEK" SH.P.K., emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj... Ajo ka vulen e saj, ne te cilën eshte shkruar "AJEK" SH.P.K, Elbasan- Albania.

NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne Elbasan, lagja "Shën Koll", tel. 35-26. Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise caktohet 10 vjet, me perjashtim te rastit kur ortaket i vendosin nje prishje te parakoshme te saj ose vendosin per shtytje te metejshme.

NENI 6

Objekti i veprimtarise do te jete :

-Eksport import të gjithë llojeve të mallrave industriale ushqimore, karburante e vajra lubrifikantë, pjesë këmbimi, servis automjetesh, agjensi doganore, spacionere e detare, komisjoner, përpunime të produkteve e nënprodukteve industriale ushqimore, shërbime të ndryshme, shitje me shumicë e pqakicë

NENI 7

Me vendimin e themeluesve te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas blerjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kte akt themelimi.

NENI 8

Themistokli Bebi
[Signature]

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqson kontributet ne para dhe eshte 100000 leke. Ky kapital ndahet ne 100 kuota te barabarta me nga 1000 leke secila. Ortaku THEMISTOKLI BEBI ka në pronësi të tij 100% të kapitalit

NENI 9

Shoqeri kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte perjegjes per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkalidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga nje keshill administrativ.Themeluesit, me vendim te vecante do te emerojne dhe nje eksperte kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin", si dhe do te krijoje fondin rezerve.Fitimi neto do te rezultoje ne fund te cdo viti financier ne baze te nenin 214 te ligjit nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare" pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjet e mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakut.

NENI 11

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emertimet e shkarkimet ne organet e saj, behen nga keshilli administrativ. Mardheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

NENI 12

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

THEMELUESI
I SHOQERISE - "AJEK"-SH.P.K.
THEMISTOKLI BEBI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
Nr. 1028

me 03.07.1997

VERTETIM


Une noterja Tamara Malaj vertetoj se perpara meje jane paraqitur z. THEMISTOKLI BEBI, i cili pasi u identifikua prej meje me ane te leternjoftimit dhe rezultuan madhor dhe te afte per te kryer veprime juridike, deklaroi se është dakort me permbatjen e aktit te mesiperm dhe e nenshkroi ate pa asnjë hezitim ne pranine time si notere.

NOTERE

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L.GURAKUQI P.2/21
TIRANE
TEL 298 32



STATUT i Shoqerise tregtare " AJEK" SH P K



Shoqeria tregtare " AJEK" SH P K krijohet ne perputhje me ligjin nr 7638 date 19.11.1992 , per shoqerite tregtare .

KREU I Dispozita te per gjithshme

NENI 1

Shoqeria "AJEK" SH P K eshte person juridik shqiptar . Ajo gezon personalitetin juridik qe nga momenti i rregjistrimit Regjistrin Tregtar dhe nr zyren e Tatimeve.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e themelimit (Akti i themelimit dhe Statuti)

NENI 2

OShoqeria "AJEK " SH P K eshte nje shoperi me per gjegjesi te kufizuar , me seli ne Elbasan, lagja "Shen Koll" Nr 10. Ajo mund te cele zyra perfaqesie, dege ose filiale ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

NENI 3

Shoqeria " AJEK " SH P K parashikohet te zhvilloje veprimtarine e saj per nje kohe prej 10 vjet esh, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj para ketij afati ose kur vendos shtyrjen e veprimtarise se saj tej afatit te mesiperm.

NENI 4

Emertimi i shoqerise eshte " AJEK ". Ky emertim vendoset ne te gjitha letrat qe perdoren per korespondence ne faturat , ne te gjitha reklamat dhe botimet e nxjerra prej saj " dhe do te pasohet nga fjala " SH.P.K." ose " Shoqeri tregtare me per gjegjesi te kufizuar " nga numri i rregjistrimit te saj dhe selia.

KREU II Objekti i veprimtarise

NENI 5

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jetë :

- Eksport - Import te te gjithe llojeve te mallrave , industriale, ushqimore,karburante e vajra lubrifikante, servis automjetesh, pjesa kembimi automjetesh, agjensi doganore, Spedicion e detare,komisioner,sherbime te ndryshme, shitje me shumice e me pakice.

NENI 6

Ortaket rezervojne te drejten te modifikojne objektin e veprimtarise ne cdo kohe .

KREU III Kapitali themeltar

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontribute ne para te nenshkuara te shlyera nga ortaket . Kapitali themeltar eshte 100000 leke i ndare ne 100 pjesa te barabarta me nga 1000 leke secila .

Ortaku Themistokli BEBI zoteron 100% te kapitalit.

KREU IV

NENI 8

Ortaket ushtrojn kompetencat qe i jane caktuar Asamblese se ortakeve , ne baze te ligjit nr 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare " . Aka marrin vendime per veprimtarine e shoqerise dhe politiken ekonomike e tregtare te saj .

Themistokli Bebi
JT

NENI 9

Vendimet ne emer te ortake~~je~~ nenshkruhen sipas parashikimeve te percaktuara ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise. Ortak~~e~~ marrin vendime per ceshjet e meposhtme:

- Miratojn~~e~~ strukturen organizative te shoqerise dhe numrin e vendeve te punes ne te.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise. Administratori i shoqerise caktohet zoti Themistokli BEBI.
- Ndryshon e modifikon statutin e shoqerise dhe kapitalin themeltar e objektin e veprimtarise se shoqerise , si dhe per ndryshimin e formes juridike te shoqerise.
- Miraton llogarite pas raportit te eksperteve kontabel.
- Emeron prishjen e shoqerise para afatit te percaktuar ne aktin e THemelimit ose per kalimin e ketij afati.
- Zmadhimin ose zvogelin e kapitalit themeltar.
- Riorganizimin , mbarimin dhe prishjen e shoqerise dhe likuidimin e saj .
- Orientimet ne baze tz tz cilave do te drejtoj~~r~~ veprimet shoqeria , e do te caktoje preferencat e politikes se saj ekonomike e komerciale . Ndermarrjen e aktiviteteve te reja afariste .
- Dhenien ner peng ose hipoteke apo siguri tjeter te ngjashme.

NENI 10

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise si dhe ato te percaktuara ne neni 50 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare ". Ai ka te drejta te plota per drejtimin operativ te shoqrise dhe mund te kryeje te gjitha veprimet qe duhen per aktivitetin e shoqerise me perjashtim te atyre qe jane parashikuar ne nenin te 9 te ketij statuti qe i perkasin ortakeve. Administratori perfaqeson shoqerine ne te gjitha veprimet juridike e financiare te saj me pale te tjera , me banka,shoqeri transporti, e tjere.

E drejta e firmes per veprimet e kryera nga shoqeria dhe qe ndodhen brenda kompetencave te administratorit sipas ketij neni i takon ketij te fundit .Ortaket kane te drejte te ezhvendesojne ne cdo kohe administratorin e emeruar me nje tjeter ose me nje keshill administrativ.

NENI 11

Ortak~~e~~ emer~~je~~ deri ne dy eksperte kontabel per nje periudhe kohe prej 6vitesh financiarete cilet ushtrojne kontroll te veprimtarise se shoqerise.

Eksperte kontabel bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe gjojkojne te nevojshme, ne cdo kohe te vititdhe te dy bashke ose vec e vec. Ata mund te shqyrtojne ne vend te gjithe dokumentacionet e shoqerise qe e vleresojne te dobishme ne ushtrimin e detyres se tyre.

KREU V Veprimtaria e shoqerise

NENI 12

Viti ekonomiko finanziar fillon me 1Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Viti i pare finanziar fillon ne daten e themelimit te shoqerise.

Pagimi i pagave, taksave e tatimeve dhe i kuotave per sigurimet shoqerore do te behet ne perputhje me dispozitat perkatese ne fuqi.

NENI 13

Shoqeria do te mbaje librin e llogarise ne leke dhe ne valute te huajdhe do te beje perllgaritjet per nxjerrjen e bilancit ne perputhje me ligjin Nr 7661 date 19.1.1993. " Per kontabiliteten".

NENI 15

Emerimi dhe marrja ne pune ,caktimi i pages per cdo punonjes dhe largimi nga puna jane kompetence e administratorit.

Themistoklo Bebi
JFK

Maredheniet e punes mes shoqerise si punedhenese dhe punemaresve rregullohet me kontratat e punes dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

KREU VI
Prishja , shperndarja dhe likuidimi

NENI 16

Shoqeria mund te shperndahet per shkaqet e meposhtme:

a) Me mbarimin e afatit te percaktuar ne nenin 3 te ketij statuti dhe ne rast iktarshimi te tij ne baze te dispozitave te ketij statuti me mbarimin e ketij afati te ri .

b) Me vendim te ortakeve.

c) Me humbjen e gjysmes se kapitalit themeltar, pasi te jete shpenzuar dhe fondi rezerv ne baze te neit 72 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992."Per shoqerite tregtare"

Ne rast se ortaket nuk marrin vendim per te plotesuar kapitalin ose zvogeluar ate ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne rastin e prishjes se shoqerise , shoqeria do te likuidohet .Ortaket dihet te caktojne nje osse disa likuidatore.

Likuidimi i shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionit te vetem te kreut te V te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare "

NENI17

Te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese qe duhet te aprovoje llogarite sociale ,keto llogari duhet te jene ne dispozion te ortakeve ne seline e shoqerise.

Keshilli i administrimit do te percaktoje rregullat operativeper ti bere tte mundur ortakeve konsultimin e librave te llogarive sociale te pakten 2 here ne vit .

NENI 18

Cdo mosmareveshje qe do te linde ndermjet ortakeve dhe administratoreve do ti ngarkohen apo jepen nje keshilli arbitrues i perbere nga 3 anetare nga te cilet dy te emeruar nga gjhykata e rrerhit Tirane.Arbitrat do te gykajne perfundimisht konfliktin e hapue shoqerise .

NENI 19

Persa nuk eshte e parashikuar nga statuti i tanishem do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

STATUT
I shoqërisë "AJEK" SH. P. K.
Themistokli BEBI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 1028

Tirane 03.07 1997

V E R T E T I M

Une noterja Tamara Malaj, vertetoj se perpara meje eshte paraqitur personalisht zThemistokli BEBI , i cili pasi nuk identifikuva nga ana e ime , deklroi se eshte dakort mëe permbytjen e akit te mesiperm dhe se nenshkrimi eshte hedhur prej tij me vullnet te lire dhe pa asgne hezitim ne pranine time.

NOTERE
TAMARA MALAJ
Rr. L. GJAKUQI P.2/21
TIRANE
TEL 298 32

Noterja

